



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUKËS

"Sheshi Skenderbej" lagj.nr.5

www.kukesi.gov.al

tel/fax 02422313

Nr 66 Prot

Kukës me 29.09 .2014

KONTRATË SIPËRMARRJE

per

"Ndertim I Kendit sportive (Palester) te Shkolles 9-Vjeçare Lidhja e Przerenit, Kukës"

Lidhur sot, më date 29/09/2014, në bazë Ligjit 7850 dt 29.07.1994 (I ndryshuar) neni 850 dhe në vazhdim të Kodit Civil, midis:

Bashkisë së Kukës e përfaqësuar nga Kryetari I saj **Hasan Halilaj**, përfaqësues I vetëm në rolin e investitorit dhe Autoritetit Prokurues që më poshtë do të quhet "Investitori";

dhe

JENOLT SH.P.K.

Shoqërisë "~~Invest~~sh.p.k.", me perfaqesuese ligjor **Z.Kujdesi Todaj**

Neni 1

Objekti I Kontratës

Objekti I kësaj kontrate është sipërmarrja me objekt: **"Ndertim I Kendit sportive (Palester) te Shkolles 9-Vjeçare Lidhja e Przerenit, Kukës"** në përputhje të plotë me projekt zbatimin e objektit.

Neni 2

Vlera e Kontratës

Kontrata lidhet me një vlerë totale me tvsh 10.093.120 leke (dhjete million e nentedhjete e tre mije e njeqind e njezet).

Neni 3

Afati I Kontratës.

Afati maksimal I përfundimit të punimeve është 4 *Muaj* nga dita e lidhjes së kontratës.

Neni 4

Gjuha e kontratës.

Gjuha në të cilën përpilohet kontrata është Gjuha Shqipe.

Neni 5

Përkufizime

Formulari I çmimit te ofertës është dokumenti I plotësuar që sipërmarrësi ka dorëzuar në datën e hapjes së tenderit dhe është pranuar nga Autoriteti Prokurues.

Vlera e kontratës është vlera e dhënë në njoftimin e fituesit që Autoriteti Prokurues I ka dërguar Sipërmarrësit fitues, mbi bazën e të cilës është plotësuar e dorëzuar formulari I kontratës, nga ky I fundit.

Data e përfundimit të kontratës është data e vërtetuar nga Autoriteti Prokurues.

Sipërmarrësi është një person juridik I pranuar nga Autoriteti Prokurues.

Ditët, janë ditë kalendarike dhe muajtë janë muaj kalendarik.

Data e fillimit është data e lidhjes së kontratës.

Ndryshimi është një udhëzim që jep Investitori I paparashikuar në dokumentat fillestare dhe jepet gjithmonë me shkrim.

Preventiv janë vëllimet e punës të plotësuara me çmime, pjesë përbërëse e ofertës.

Raste të kompensuara janë ato që përcaktohen në pikën 25.



Difekte është çdo pjesë e punimeve të parealizuara në përputhje me kontratën.

Periudha e garancisë së difekteve është 1 vjet.

Skica (vizatimet) përfshijnë projektet dhe të dhëna të tjera të paraqitura ose të miratuara nga Autoriteti Prokurues për përmbushjen e Kontratës.

Investitori është organi lokal që vë në dispozicion fondin.

Autoriteti Prokurues është organi qëndror ose lokal që realizon prokurimin e objektit.



Mbikqyrësi I Punimeve është personi kompetent I emëruar nga Investitori dhe që I është njoftuar Sipërmarrësit, I cili është përgjegjës për mbikqyrjen e realizimit të punimeve dhe administrimin e kontratës.

Drejtori Teknik I Punimeve në objekt është personi I aprovuar nga Autoriteti Prokurues , përfaqësues I Sipërmarrësit, përgjegjës për kryerjen dhe përfundimin e punimeve, për të cilën sipërmarrësi është I detyruar t'I konfirmojë Investitorit emrin e tij.

Paisjet janë makinerit e Sipërmarrësit të sjella përkohësisht në kantierin ku do të kryhen punimet.

Materialet janë furnizimet që përfshijnë edhe ato të konsumit të përdorura nga Sipërmarrësi për kryerjen e punimeve, në përputhje me standartet e RSH.

Specifikimet janë karakteristikat e punimeve të përfshira në projektet e zbatimit në dokumentat standarte të tenderit dhe çdo modifikim ose shtesë e bërë dhe e miratuar me shkrim nga Investitori.

Dokumentat e tenderit janë pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

Punimet janë punimet që duhet të kryhen nga Sipërmarrësi në përputhje me kontratën, projektin dhe ndryshimet e tij.

Neni 6

Komunikimi

6.1 Komunikimi midis palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim në adresat e deklaruara nga palët, në rast se ka ndryshim të adresës palët janë të detyruara të informojnë për çdo ndryshim. Njoftimi bëhet efektiv vetëm pasi të dorëzohet.


Neni 7

Prona Intelektuale

7.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Sipërmarrësi gjatë zbatimit të kontratës do t'I përkatësin Investitorit, I cili mund t'I përdorë ato sipas gjykimit të tij.

7.2 Me përjashtim të rasteve kur palët bien dakort ndryshe, Sipërmarrësi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'I paraqesë Investitorit të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet , statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pergatitura nga Sipërmarrësi gjatë zbatimit të kontratës. Sipërmarrësi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t' përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Prokurues.

7.3 Sipërmarrësi duhet të sigurojë Investitorin nga mos përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga përdorimi I materialeve skicave ose çdo pronë tjetër sipas kontratës. Sipërmarrësi duhet t'I japë Investitorit të gjitha provat dhe informacionin në posedim të tij që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.



Neni 8

Mbikqyrësi I Punimeve

8.1 Mbikqyrës I punimeve do të jetë Z./Znj. _____ me licencë "Për mbikqyrje dhe kolaudim punimesh" Nr. _____, lëshuar nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Komisioni I Dhënies së Liçensave Profesionale,

8.2 Detyrat e mbikqyrësve të punimeve burojnë nga aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi dhe detajohen në kontratën e shërbimit që do të lidhet me këta të fundit.

8.3 Në rast se mbikqyrësi do të ndryshohet, Investitori njofton menjëherë Sipërmarrësin.

Neni 9

Personeli I Sipërmarrësit

9.1 Sipërmarrësi do të punësojë vetëm personelin e deklaruar në ofertë për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga Mbikqyrësi I Punimeve. Mbikqyrësi I Punimeve do t' propozojë Investitorit për të zëvendësuar personelin kryesor, vetëm nëqoftëse kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë baraz ose me të larta se ato të personelit të përcaktuar në ofertën e Sipërmarrësit.

9.2 Në qoftë se Mbikqyrësi I Punimeve I kërkon Sipërmarrësit që të largojë një person, I cili është anëtar I personelit ose I fuqisë punëtore të Sipërmarrësit, duke theksuar arsyet, Sipërmarrësi do të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri I punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë më lidhje me punën e përfshirë në kontratë.

9.3 Drejtori Teknik I Punimeve të objektit është Z. _____, me licencë Nr. _____. Lëshuar nga Ministria e Punëve Publikë, Komisioni I Dhënies së Liçensave Profesionale.


Detyrat e Drejtuesit Teknik të Punimeve janë si më poshtë:

- Zbatimin e objektit Konform projektit dhe kushteve teknike të zbatimit;
- Dokumentacionin teknik që është I detyrueshëm të mbahet në object;
- Korrespondencën zyrtare me Mbikqyrësin e Punimeve;
- Ecurinë e zbatimit të punimeve konform plan organizimit dhe grafikut të punimeve;
- Është I pranishëm në të gjitha fazat e realizimit të objektit: zbatimin e punimeve, dorëzimin dhe kolaudimin e objektit.

9.4 Në rast se ndryshohet Drejtuesi Teknik, Sipërmarrësi duhet detyrimisht të lajmëroje Mbikqyrësin e Punimeve I cili vë në dijeni Investitorin.

Neni 10

Detyrimet e Sipërmarrësit



10.1 Sipërmarrësi do të kryejë punimet në përputhje me projektet e ndryshimet e miratuara, dhëna nga Investitori dhe specifikimet teknike të dhëna në dokumentat e tenderit. Formulari I çmimit të ofertës (preventive) I plotësuar nga sipërmarrësi, specifikimet teknike dhe projekti I dhënë në tender I bashkëngjiten kësaj kontrate.

10.2 Drejtuesi Teknik I Punimeve në kantiër, është I detyruar të mbajë ditarin e objektit, ku të përfshihen të gjitha punimet e kryera dhe urdhërat e dhëna për zbatimin e projektit. Ky ditar në çdo kohë do t'i vihet në dispozicion Mbikqyrësit të Punimeve, grupit të Kolaudimit dhe Investitorit.

10.3 Sipërmarrësi është përgjegjës I punimeve ndaj investitorit

10.4 Sipërmarrësi ka për detyrë të ruajë projektin dhe të mos e përdorë atë në objekte të tjera jashtë këtij tenderi. Gjithashtu, të mos japë asnjë informacion (botim artikujsh, apo fotografish) mbi ecurinë e punimeve pa lejen e Investitorit.

10.5 Sipërmarrësi është I detyruar të marrë të gjitha masat për kufizimin e ndotjes së Ambientit, duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion.

10.6 Sipërmarrësi është I detyruar të pajisë punonjësit e tij në objekt me uniforma, në të cilat të jenë shprehur shenjat dalluese të shoqërisë Sipërmarrëse.

10.7 Sipërmarrësi është I detyruar të përdori mjetet e sinjalistikës rrugore për punime në rrugë me qëllim disiplinimin e trafikut të mjeteve dhe kalimtarëve në objektin e ndërtimit

10.8 Në rast të mos respektimit të dispozitave të parashikara në pikat 10.5-10.6-10.7 të mësipërme Mbikqyrësi I punimeve I bën njoftim Sipërmarrësit për respektimin e detyrimeve të shprehura më lart. Në rast se Sipërmarrësi nuk merr masa brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit atëherë Mbikqyrësi I punimeve I propozon Investitorit aplikimin e një penalteti në masën nga 5.000 lekë deri në 20.000 lekë, penaltet I cili do të mbahet nga situacioni.

10.9. Sipërmarrësi do të heqë lenden drusore nga catite e pallateve dhe do ta dërgoj pranë ish-spitalit ushtarak



Neni 11

Testimet dhe Inspektimet

11.1 Sipërmarrësi është I detyruar që me shpenzimet e veta të kryejë provat laboratorike të materialeve që do të përdoret në objekt, si dhe provat e kampioneve të marra nga objekti në përputhje me udhëzimet e dhëna nga Mbikqyrësi I Punimeve.

11.2 Sipërmarrësi duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës, kosto e këtyre testeve dhe inspekteve duhet të financohet tërësisht nga Sipërmarrësi, brenda kushteve të çmimit të kontratës.

11.3 Investitori gjithashtu mund t'i kërkojë Sipërmarrësit të bëjë teste ose inspekte shtesë të pa parashikuara në kontratë, për të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se ndërtimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës.



11.4 Investitori do të refuzojë çdo punim ndërtimi që nuk e kalon testimin dhe /ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

11.5 As ekzekutimi I testeve, as inspektimi I punimeve të ndërtimit nuk do ta lirojë Sipërmarrësin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 12

Ngritja e Kantierit

12.1 Sipërmarrësi do të mbajë përgjegjësi për skicimin e Ngritjes së Kantierit.

12.2 Sipërmarrësi duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek Mbikqyrësi I Punimeve për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 13

Sigurimi Teknik

13.1 Sipërmarrësi është përgjegjës për të gjithë veprimtarinë në kantierin e ndërtimit, duke zbatuar masat korigjuese dhe rregullat e sigurimit teknik për të gjithë personelin sikurse përcaktohet në legjislacionin Shqiptar.

Neni 14



Rreziqet e Sipërmarrësit dhe Forca Madhore

14.1 Sipërmarrësi ka për detyrë të përballojë të gjitha shpenzimet që mund të dalin nga data e fillimit të punimeve e deri në fund të periudhës së garancisë për difektet që mund të shfaqen në objekt sipas të dhënave të kontratës. Sipërmarrësi deri në përfundim të punimeve do të përballojë rreziqet për shkak të dëmtimve të personelit, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë (përfshirë pa kufizime punimet, materialet dhe paisjet, kantierin e ndërtimit si dhe objektin e ndërtimit).

14.2 Sipërmarrësi nuk do të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të kontratës jo për fajin e tij, dëmeve të likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësimin nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatimin ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat I ndodhjes së Forcës Madhore.

14.3 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të Sipërmarrësit dhe e parashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga veprimet e Investitorit qoftë në kapacitetin e tij Sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, përmytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngimet të karantinës dhe embargo tranziti.

14.4 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Sipërmarrësi duhet të njoftojë menjëherë Investitorin. Me përjashtim kur Investitori jep direktiva të ndryshme, Sipërmarrësi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën



praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin e kontratës deri në masën e mos pengesës nga Forca Madhore.

Neni 15

Sigurimi

15.1 Sipërmarrësi duhet të bejë sigurimin e kontrates në masën 10% me vlerë totale 1.009.312 *lekë* para lidhjes së kontratës, por jo më vonë se 30 ditë nga marrja e njoftimit për fitimin e kontratës.

15.2 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

Neni 16

Preventiv

16.1 Preventivi do të përfshijë të gjitha zërat e punimeve me çmimet përkatëse të parashikuara në ofertë.

16.2 Preventivi do të përdoret për të llogaritur vlerën e kontratës. Sipërmarrësi paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit, bazuar për çdo zë pune të preventivit.

16.3 Për zërat e reja, të paparashikuara në preventive përveç dokumentacionit përkatës paraqitet edhe analiza teknike për çdo zë të ri pune.

16.4 Nën/zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë çmim për njësi në ofertën e paraqitur, do të konsiderohen si të mbuluara nga vlerat e tjera të përfshira në kontratë.


Neni 17

Negociatat dhe Amendamentet

17.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që kanë përbërë bazën e përzgjedhjes së Sipërmarrësit.

17.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qenë me shkrim, me datë dhe duke iu referuar shprehimisht kontratës. Çdo shtesë ose ndryshim Amendamenti do të jetë i vlefshëm vetëm në rast se nënshkruhet nga të dyja palët ose nga persona të autorizuar prej tyre.

17.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhen me shkrim, në të cilën të specifikohet data dhe të nënshkruhet nga pala ose nga një përfaqësues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.



Neni 18

Ndryshimi I porosisë

18.1 Kushtet e kontratës mund te ndryshohen .Çdo amendament I kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe I nënshkruar nga Investitori dhe Sipërmarrësi.

18.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rëthana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

18.3 Investitori që në çdo kohë mund të porosisë Sipërmarrësin të bëjë ndryshime Brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin prej tyre e parashikuara më poshtë:

-Korrigjime në skicimin, vizatimin ose specifikimet e Ndërtimeve.

-Korrigjime në material,

-Korrigjime në sasi



18.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Investitori dhe Sipërmarrësi duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit te kontratës dhe /ose ndryshim ne afatin e dorëzimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi.

18.5 Ndryshimi I porosive nuk do të jetë I vlefshëm në se nuk formalizohet sipas kërkesave të nenit 18 të kësaj kontrate.

18.6 Çdo ndryshim I urdhëruar nga Investitori, do të jetë detyrimisht objekt I një process-verbali (urdhëri) me shkrim I firmosur nga Investitori.Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e Investitorit dhe në bazë të një propozimi teknik nga ana e Investitorit dhe në bazë të llogarive përkatëse të bëra nga Sipërmarrësi dhe Mbikqyrësi I Punimeve, mbështetur në çmimin njësi për cdo zë pune shprehur në preventiv.

18.7 Çdo ndryshim I cili sjell rritjen e vlerës së kontratës duhet të dokumentohet gjatë zbatimit të punimeve dhe pasi pregatitet dokumentacioni përkatës si preventive shtesë, vizatime etj., I propozohen zyrtarisht entit që delegon fondin që të miratojë shtesën e vlerës së plotë si dhe për të gjetur burimet e financimit.

18.9 Nëse volume përfundimtare të punimeve të kryera, ndryshojnë nga volume në preventive dhe vlera e tyre është Brenda preventivit të objektit dhe fondit rezerve të parashikuar në preventive, investitori ngarkon mbikqyrësin për të verifikuar volume dhe për të dokumentuar ndryshimet e mundëshme dhe pastaj I miraton ato.



Neni 19

Programi

19.1 Brenda 5 ditëve nga nënshkrimi I kontratës Sipërmarrësi do t' I paraqesë për miratim Mbikqyrësit të Punimeve një program, në të cilin tregohet mënyra e kryerjes së punimeve dhe grafiku kohor. Sipërmarrësi do të realizojë programin sipas grafikut të parashikuar. Sipërmarrësi ka të drejtë t' I propozojë mbikqyrësit të punimeve ndryshime në grafikun e punimeve, duke I motivuar ato.

19.2 Në rast se mund të lind nevoja e dorëzimit të pjesshëm të punimeve këto parashikohen në grafikun e punimeve ose në ndryshimet e propozuara dhe të miratuara nga investitori.

Neni 20

Korrigjimi I Difekteve

20.1 Sa herë që gjatë periudhës së zhvillimit të punimeve, nga Mbikqyrësi konstatohet një difekt sipërmarrësi është I detyruar ta korrigjojë atë Brenda afatit që I lihet me shkrim, por jo më vonë se 15 ditë.

20.2 Gjatë periudhës së garancisë së punimeve Mbikqyrësi I punimeve do të njoftojë Sipërmarrësin lidhur me çdo difekt para mbarimit të kësaj periudhe. për eliminimin e difekteve lihet një afat I cili saktësohet sipas çdo rasti konkret, por jo më shumë së 15 ditë.


20.3 Periudha e garancisë për difektet është afati *I vit*. Me përfundimin e kësaj periudhe Sipërmarrësi paraqet kërkesën e kthimit të vlerës së garancisë së punimeve e cila I është mbajtur nga Investitori. Ky I fundit, Brenda 10 ditëve organizon vizitën në terren ku kontrollohen realizimet e detyrave të lëna nga korrigjimi I difekteve të lindura gjatë periudhës së garancisë së punimeve. nëse janë kryer gjithë korrigjimet e difekteve atëherë hartohet akti përkatës I marrjes në dorëzim të objektit dhe që shenon përfundimin e detyrimeve reciproke të kontratës së sipërmarrjes dhe asaj të mbikqyrjes së punimeve.

Neni 21

Difektet e Pakorrigjuara

21.1 Në qoftëse Sipërmarrësi nuk korrigjon difektet e konstatuara në periudhën e garancisë së difekteve, Brenda afatit të përcaktuar, Investitori do të vlerësojë koston e korrigjimit të difektit, dhe Sipërmarrësi do të paguaj këtë shumë, së bashku me nje gjobë të veçantë e cila do të jetë 0.04% të vlerës së kontraktuar për çdo ditë vonesë. Investitori do ta mbajë këtë shumë duke e zbritur nga garancia e punimeve e cila është mbajtur progresivisht në situacione.

21.2 Në se me përfundimin e periudhës së garancisë Sipërmarrësi nuk ka korrigjuar difektet e konstatuara, Investitori I zbret nga garancia deri në konfiskimin e krejt garancisë së punimeve.



Neni 22

Situacionet

22.1 Sipërmarrësi do t'i paraqesë Mbikqyrësit të Punimeve Brenda 5 ditëve të para të çdo muaji situacionet mujore progressive për punimet e kryera, duke zbritur pagesat e situacioneve të mëparshme, garancinë e difekteve, paradhënien etj., të kësaj natyre, sikurse përcaktohet në këtë kontratë.

22.2 Mbikqyrësi I punimeve do të kontrollojë punën e kryer nga sipërmarrësi dhe do të vërtetojë shumën që duhet t'i paguhet sipërmarrësit Brenda 10 ditëve nga paraqitja e situacionit. Gjatë kontrollit mbikqyrësi përcakton vlerën e punimeve të kryera.

22.3 Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe të shprehura në preventive, vlerën e ndryshimeve dhe të rasteve të kompensuara pa prekur fondin rezervë, I cili do financohet në situacionin përfundimtar në se ka dokumenta që argumentojnë përdorimin e tij.

Neni 23

Pagesat

23.1 Pagesat për çdo situacion punimesh do të kryhen nga investitori Brenda 15 ditëve nga dita e firmosjes së situacionit nga mbikqyrësi I punimeve. Pagesat e situacioneve do të kryhen në numërin e llogarisë bankare të sipërmarrësit.

23.2 Pagesa e situacioneve do të kryhet sipas financimit të parashikuar në pikën 2 të kësaj kontrate.

Neni 24

Rastet e kompensuara

24.1 Rastet e kompensuara për të cilat vonesa justifikohet do të konsiderohet si vijojnë:



a) Mbikqyrësi I punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet) specifkimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar.

b) Mbikqyrësi I punimeve udhëzon sipërmarrësin për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat pas kryerjes së punimeve;

c) Autoritetet publike ose investitori shkaktojnë vonesa në lirimin e sheshit të ndërtimit për sipërmarrësin;

d) Investitori vonon, pa arsye, lëshimin e certifikatës së marrjes në dorëzim.

24.2 Kompensimi I rasteve të sipërpërmendura do të bëhet si vijon: Për vonesat e përmendura në pikat 24.1 (a,b,c,d) investitori do të njohë shtyrjen e datës së përfundimit të punimeve mbi atë të parashikuar në këtë kontratë.



Neni 25

Taksat

25.1 Sipërmarrësi është i detyruar të paguajë të gjitha taksat në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

25.2 Për taksat e përcaktuara në legjislacionin që ka hyrë në fuqi 28 ditë para datës së hapjes së tenderit, të cilat sipërmarrësi duhet t'i ketë marrë parasysh në vlerën e kontratës, investitori nuk do t'i njohë asnjë shtesë pagese.

Neni 26

Dëmshpërblimi për vonesat

26.1 Sipërmarrësi do t'i paguajë investitorit dëmshpërblimin për vonesat në mbarimin e punimeve në masën 0.004 % në ditë të vleres koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës.

26.2 Sasia e përgjithshme e dëmeve të likujduara nuk do të tejkalojë 25% të vlerës së Kontratës. Investitori do të zbrisë dëmshpërblimin për vonesat nga pagesa e fundit e Sipërmarrësit.

Neni 27

Garancia e Difekteve

27.1 Garancia e difekteve do të jetë 5% e vlerës së kontratës që do t'i mbahet nga çdo situacion sipërmarrësi si garanci për cilësinë e punimeve, shumë e cila do të paguhet mbas përfundimit të periudhës së garancisë së punimeve, duke marrë parasysh edhe saksionet e parashikuara në pikën 21 të kësaj kontrate.



Neni 28

Kostoja e Riparimeve

28.1 Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoret për punimet nga dita e fillimit deri në marrjen në dorëzim, si dhe gjatë afatit të garancisë së difekteve do të mbulohet nga sipërmarrësi me shpenzimet e tij në qoftëse humbja ose dëmtimi janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.

28.2 Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës, nëse janë për shkak të mosplotësimit të kontratës ose të punës jo cilësore të sipërmarrësit, do të mbulohen nga ky I fundit me shpenzimet e tij.

Neni 29



Marrja në dorëzim e punimeve

29.1 Sipërmarrësi pas përfundimit të punimeve njofton me shkrim mbikqyrësin e punimeve dhe investitorin. Nëse mbikqyrësi nuk ka vërtetë ky njoftim shënon datën e përfundimit të punimeve. Sipërmarrësi pas njoftimit të përfundimit të punimeve I paraqet Brenda 30 ditëve mbikqyrësit të punimeve dokumentacioni dhe llogaritjet përfundimtare për punimet e kryera. Mbikqyrësi I punimeve mbas verifikimeve, Brenda 30 ditëve së bashku me relacionin e tij ia paraqet gjithë dokumentacionin investitorit.

29.2 Mbas marrjes së gjithë dokumentacionit investitori I paraqet komisionin të kolaudimit gjithë dokumentacionin e realizimit të objektit. Me përfundimin e procedurave të kolaudimit investitori lëshon çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve të kryera dhe do të çlirojë garancinë e sigurimit të kontratës. Nga data e akt-kolaudimit të punimeve fillon periudha e garancisë së punimeve.

29.3 Në fund të periudhës së garancisë së punimeve, mbikqyrësi I punimeve dhe komisioni I marrjes në dorëzim të objektit do të përpilojë së bashku me investitorin aktin e marrjes në dorëzim të veprës, objekt I kësaj kontrate.

Neni 30

Zgjidhja e kontratës

30.1 Investitori ose Sipërmarrësi mund të pezullojë kontratën kur vëren shkelje themelore të saj.

30.2 Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë por nuk kufiozohen në sa vijon:

a) Sipërmarrësi nuk fillon punë Brenda 5 ditëve nga nënshkrimi I kontratës si dhe në rastet kur ndalohen punimet më shumë se 10 ditë, kur nuk parashikohet në programin e punës dhe ndalimi I punimeve nuk është I autorizuar nga mbikqyrësi I punimeve dhe nuk respektohet grafiku I punimeve.

b) Mbikqyrësi I punimeve udhëzon pezullimin e punimeve duke njoftuar investitorin dhe sipërmarrësin.


c) Sipërmarrësi falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindërtimit ose bashkimit të shoqërisë.

d) Sipërmarrësi vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korrigjimet e difekteve të propozuara nga Mbikqyrësi I Punimeve.

Neni 31

Pagesa pas zgjidhjes se kontratës

31.1 Në rast se kontrata priset nga investitori për arsye objektive, mbikqyrësi I punimeve do të lëshojë një çertifikatë për vlerën e punës së kryer duke zbritur pagesat e marra deri në datën e lëshimit të çertifikatës.



Neni 32

Pasuria

32.1 Të gjitha punimet e kryera dhe materialet e montuara për realizimin e objektit do të konsiderohen si pronë e investitorit në rast prishje kontrate.

Neni 33

Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

33.1 Investitori dhe sipërmarrësi do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrveshje që do t'u lindë gjatë realizimit të kësaj kontrate.

33.2 Në rast se palët nuk bien dakort atëherë për sqarimin e mosmarrëveshjeve palët do t'i drejtohen Gjykatës së rrethit Kukes.

Neni 34

Legjislacioni bazë

34.1 Ligji I aplikueshëm do të jetë Legjislacioni Shqiptar.

Neni 35

Dispozita të Fundit


35.1 Kjo kontratë perbehet nga 15 flete dhe do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga të dy palët. Kjo kontratë u hartua në 3 (tre) kopje, dy nga të cilat I mban Investitori dhe një kopje e mban Sipërmarrësi.

SIPËRMARRËSI

"Denolt" SH.P.K

PERFAQESUESI LIGJOR

Kujdesi Today



PER INVESTITORIN

KRYETARI

Hasan HALILAJ

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Hasan HALILAJ". Below the signature is a circular stamp with a double border. The text inside the stamp is partially obscured by the signature but appears to include "PER INVESTITORIN" and "KRYETARI".